- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha dimensionet e atikujve të përfshira në kërkesë do ti gjeni si më poshtë:

1. Stilolaps me logo

Stilolaps me ngjyrë të bardhë dhe të zezë, branduar me logon dhe Posta Shqiptare Sh.a, materiali pleksiglas, me përmasa 14.2 cm x 1 cm, hapësirë stampimi 5 cm x 0.8cm dhe bojë shkrimi blu. Logo me ngjyrë gold dhe blu U.V. Me printim dhe llakim parcial nga 2 anët.

2. Bllok i vogël me mekanizëm dhe mbyllje në formë zarfi

Bllok shënimesh me formë të vogël, dizajnuar me ngjyra institucionale (blu e errët dhe e verdhë), me mbyllje anësore në formë zarfi dhe buton plastik. Përmasat: 14 cm x 18 cm (formë “notebook i vogël”), kapak i fortë 300 gr, plastifikim mat ose soft-touch, ngjyrë blu me printim me ngjyra blu institucionale + e verdhë. Printimi me llakim parcial logo + slogan, mbyllje me kapëse butoni plastike në anë (formë zarfi). Pjesa e brendshme, fletë me vija, 80 faqe (40 fletë) letër 80–90 gr/m².

3. Notebook me quotes + pulla Postar Note Book

Notebook promocional i Postës Shqiptare do të përmbajë:

✓ Quotes të përzgjedhura për motivim, komunikim apo frymëzim.

✓ Pullë postare si elementë grafikë dekorativë.

Përmasat: 16 x 10 cm (formati më i përdorshëm dhe praktik). Fletë 185 faqe (ose 92 fletë të palosura). Letra 90–100 gr (e bardhë). Mbulesa, kapak i fortë 300 gr, plastifikim mat ose soft-touch, cepa të rrumbullakosur për një stil më modern, gilded edges (ose skajet e librit të veshura me ar) për përdorim dekorativ dhe mbrojtës. Lidhja me ngjitje me shpinë të sheshtë. Dizajni i jashtëm, ngjyra kryesore: blu e postës (sipas brandbook) logo + slogan, në qendër me ngjyrë gold sipas dizainit pas miratimit. Faqja e parë e brendshme (hyrëse) sfond i bardhë, logo e madhe në qendër, tekst mirëseardhjeje ose përshëndetje. Faqja e dytë e brendshme, hapësirë e dedikuar vendosjes së një pulle postare ku të dizajnohet një kuadrat me ngjyrë gold me përmasat 5 x 5 cm (vendosje taskine). Quote motivuese në faqen e parë të çdo muaji dhe faqet e tjera të jenë me data kalendarike për çdo muaj.

4. Dosje të thjeshta me logo publicitare

Dosje të verdha dhe blu tip folder, mat, përmasat: 31cm x 22cm me kurriz, trashësia 1 cm, aksesori për vendosje kartëvizite e branduar logo dhe slogani i Posta Shqiptare Sh.a në pjesën e përparme dhe në pjesën e pasme fundore të jetë logo e Postës, adresa e kompanisë, adresa e web-it www.postashqiptare.al. dhe kanalet e rrjeteve sociale. Print 4 ngjyra CMYK. Karton 350gr. Llakim parcial U.V. Prerje me formë. (imazhi printimit sipas dizainit pas miratimit).

5. Çantë e mëdha kartoni

Çantë e madhe kartoni, mat, materiali karton, në ngjyrë të zezë dhe blu, me doreza (lidhëse sintetik) në ngjyrë të zezë, përmasat: 35cm x 30cm x 10cm, e branduar logon e Postës Shqiptare dhe slogani i Posta Shqiptare Sh.a, shkrimi ngjyrë varak i verdhë.

6. Çantë beze

Çantë beze - Posta Shqiptare (ngjyrë bezhë, edicion praktik & ekologjik). Çantë tekstili me përdorim të përditshëm ose institucional. Branding i thjeshtë, funksional dhe i dukshëm për identitetin zyrtar të Postës Shqiptare. Përmasat standard: Lartësi: 38 cm, Gjerësi: 34 cm, Thellësi (fund i palosur): 8–10 cm. Gjatësia e dorezave: 60 cm (për ta mbajtur lehtësisht në sup) Ngjyra e çantës: Bezhë natyrale (100% pambuk ose tekstil i riciklueshëm) Logo & slogan: printim me llakim parcial ngjyrë blu.

7. Flamuj të mëdhenj + stativë (me logo të Postës)

Flamuj standart, model për përdorim institucional dhe ceremonial, dimensionin 150 x 100cm, të branduar me logo të Postës, sfondi i verdhë, logo blu, i printuar në të dyja krahët. Material: Saten poliestër 115–130 gr/m², rezistent ndaj lagështirës, dritës dhe rrudhave. Bazament (stativ) metalik i nikeluar, për flamuj standart + majë dekorative: ngjyrë argjend, dimensionin 210cm x 40cm.

8. Flamuj të vegjël + stativë (Poste + Shqiptar)

Flamuj tavoline (Poste + Shqiptar) model protokollar për zyra. Flamuri i Postës + Flamuri Shqiptar Ngjyra bazë: E verdhë, Logo & tekst: Blu e thellë, Flamuri Shqiptar kuq e zi. Material: Saten poliestër 115–130 gr/m². Përmasat e flamurit, Gjatësia (lartësia): 24 cm, Gjerësia (në bazë): 16 cm, shtylla metal inox / alumini i lëmuar, lartësia totale: 35–38 cm, majë dekorative: metalike – konike ose sferike, baza (mbështetësja) metal i rëndë (me peshë për stabilitet).

9. Fletëpalosje (shërbime, histori, inovacion)

Fletëpalosje me përmasa: A4 me palosje sa 1/3 e A4, 2 anë print, 4 color, letra 170 gr. (imazhi i printimit sipas dizainit pas miratimit) tematika dhe teksti që do përmbajë fletpalosja do miratohen nga Posta Shqiptare, branduar me logon e Postës Shqiptare.

10. Kalendarë tavoline vjetor

Kalendarë tavoline me 6 fletë të printuara në 2 anë me llakim parcial. Me foto të ndryshme. Branduar me logon e Postës Shqiptare. Kapja me spirale në pjesën e sipërme. Bazament i printuar 4 color. A5. Karton 400gr. Me plastifikim.

11. Poster (tematika të ndryshme)

Poster me përmasa 50cm x 70cm, 1(një) anë print, 4 ngjyra CMYK, letra 250 gr. mat të mos ketë reflektim nga blici i aparatit. Tematika dhe teksti që do përmbajë posteri do miratohen nga Posta Shqiptare, branduar me logon e Postës Shqiptare. (imazhi printimit sipas dizainit pas miratimit),

12. Varëse çelësash me mekanizëm ku të vendosen pulla

Varëse çelësash me mekanizëm, material aliazh metali ose çelik inox me trajtim anti-korrozioni rezistente ndaj deformimit me pamje të pullave postare në një anë dhe në anën tjetër logo të gravuar tekstin (“SHQIPËRIA”, “POSTA SHQIPTARE”, “SHPEJT. SIGURT. KUDO.”) Dizajni grafik, forma drejtkëndore me cepa të rrumbullakosur. Rezistent ndaj konsumimit dhe lagështisë. Dizajn premium për përdorim institucional ose suvenir, pesha 25-30 gr, ngjyrë argjend sateni (matt silver finish). Përmasat, gjatësi totale (trup + unazë) 70mm. Trupi i varësës 40mm lartësi x 30mm gjerësi, trashësia 2,5-3mm, diametri i unazës 30mm.

13. Aksesorë tavoline për vendosjen e shënimeve

Aksesorë tavoline për vendosjen e shënimeve/sticky notes, dizajn kubik me cep të hapur për akses të lehtë. Ngjyrat blu e errët zyrtare (Posta Shqiptare). Logoja e pozicionuar përballë në pjesën e përparme të kutisë, ngjyrë e verdhë në sfond blu. Përmbajtja: Logoja zyrtare e Postës Shqiptare + mbishkrimi “POSTA SHQIPTARE” dhe slogani “SHPEJT • SIGURT • KUDO”. Përdorimi i ngjyrave dhe brendimit në përputhje me identitetin vizual të Postës Shqiptare. Materiali plastikë ose karton i fortë i lyer me ngjyra matte. Madhësia standarde për mbajtësen sticky notes: 9 cm x 9 cm x 5 cm.

14. Zarfa filatelikë + katalog

Katalog filatelik, print me 4 ngjyra në 2 faqe, përmasat 25cm x 20cm, letër 300 gr, me lustër, me palosje në mes, branduar me logon e Postës Shqiptare. Katalogu do të përbëhet nga 5 faqe të plota të palosura në

mes. Dizajni dhe teksti i katalogut do të jetë sipas ngjyrave të përcaktuara në brandbook-un e Postës Shqiptare dhe do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

Zarf filatelik me përmasa 15 x 11 cm, material letër premium 140–170 gsm, ngjyrë krem. dizajni dhe teksti i zarfit filatelik do të jetë sipas ngjyrave të përcaktuara në brandbook-un e Postës Shqiptare dhe do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

15. Vulë me dyllë me gdhendje

Vulë me dyllë për mbyllje zarfi, suvenire institucionale, ftesa zyrtare. Pjesa vulosëse (disku metalik) aliazh bronzi ose latuni (brass) i gdhendur me precizion, diametër 2.5 cm. Doreza dru i lëmuar me vaj natyral e shkëputshme nga pjesa metalike (me filetë për ndërrim të dizajnit). Kapëse metalike, vidhosje bronzi e përforcuar, e qëndrueshme ndaj nxehtësisë së dyllit. Dizajni i Vulës do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare. Stil gravurë konkave (e zhytur) për shtypje pozitive në dyll.

16. Printim në adeziv për sinjalistikën e sporteleve

Printim në adeziv për zyrat qendër të çdo filiali me imazhe dhe mesazhe të përcaktuara nga Posta Shqiptare, branduar me logon e Postës Shqiptare, print me 4 ngjyra CMYK (adeziv fosforeshent për sinjalistikë) dhe prerje sipas përmasave të tabelave me sipërfaqe ekzistuese.

17. Korniza pecikllaz për vendosjen e posterave në formatin 50x70

Kornizë pecikllaz për postera – format 50x70 cm. Përmasa e jashtme e kornizës rreth 54 x 74 cm, gjerësia e profilit të pecikllazit 2.5 cm ose 3.2 cm (standarde). Pllaka e pasme polistiren i fortë. Pjesa e përparme fletë PVC transparente anti-refleks (për mbrojtje të posterit). Mekanizmi i hapjes do të jetë në pjesën e pasme të kornizës me kapse metalike në 4 anët që lejojnë vendosjen dhe zëvendësimin e lehtë të posterit.

18. Konkorda (spila) me imazhe të pullave

Konkordë me formë ovale klasike, me përmasa 4 cm lartësi x 2,5 cm gjerësi. Materiali i kornizës, metal i lehtë, i lyer me ar (gold-tone alloy), shtresa e sipërme: emalim i qelqtë me shkëlqim, pjesa e pasme mbërthyes klasik me gjilpërë metalike, motivi qendror imazhe të pullave.

19. Printim manualit të unifikimit të zyrave postare

Printimi full color, të dyja anët, përmasat 30cm x 21cm (format vertikal A4), kapaku letër 300 gr, me lustër, letra e brendshme 200 gr/m², me me lustër, numri i faqeve 32 (së bashku me kapakun ose 16 fletë

të palosura në mes). Dizajni dhe teksti i manualit do të jetë sipas ngjyrave të përcaktuara në brandbook-un e Postës Shqiptare dhe do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

20. Suvenir ose mbajtëse për stilolapsa me elementë postar

Mbjtëse për stilolapsa materiali plastikë cilësore, sipërfaqe mat ose me shkëlqim të lehtë, ngjyra trupit (mbajtëses për stilolapsa) blu e thellë, logo e stampuar ngjyrë e verdhë. Përmasat lartësia: 11–12 cm. Gjerësia / Diametri: 8 x 8 cm (katrore) ose Ø 8 cm (cirkulare), Kapaciteti: Deri në 15–20 lapsa ose pena. Dizajni artistik (opsional për modelin blu) silueta postieri, biçikletë postare, vulë zarfi, elementë grafikë shqiptarë, logo qendrore, pa ndryshime.

21. USB 16 giga në format karte bankomati me logo Postës Shqiptare

Format kartë plastike me përmasa standarde të kartave bankare (85.60 × 53.98 mm). Materiali PVC i qëndrueshëm me përfundim mat. Ngjyra bazë e verdhë sipas ngjyrave të përcaktuara në brandbook-un e Postës Shqiptare, kënde të rrumbullakosura, për përdorim praktik në portofol, memorie 16 GB, portë USB standard e tërheqshme nga ana e majtë. Dizajni grafik, logo zyrtare e Postës Shqiptare ngjyrë blu e errët. Tekst POSTA SHQIPTARE me font modern, gjithashtu në ngjyrë blu, e vendosur poshtë logos.

22. Aromatizues makine

Forma drejtkëndëshe me cepat e rrumbullakosur, përmasat: ~7.5 cm lartësi x 5 cm gjerësi, materiali karton aromatik me veshje speciale që lëshon aromë për 30 ditë. Ngjyra e verdhë, logo e stampuar në ngjyrë blu sipas versionit zyrtar, tekst “POSTA SHQIPTARE” në font të pastër blu nën logon, litar i hollë elastic për varje në ngjyrë të zezë. Përdorim për varje në pasqyrën e brendshme të makinës, paketuar individualisht në qese plastike me mbrojtje aromatike.

23. Sticker notes me logon e Postës

Formë katrore, përmasat: 7.5 cm x 7.5 cm, pesha letre: 70–80 gr/m². Letër e verdhë për shënime, shtresë ngjitëse në pjesën e sipërme të çdo flete, rezistente ndaj tharjes dhe lehtë e shkëputshme, dizajni grafik logo zyrtare e Postës Shqiptare, ngjyrë blu, pozicion në cepin e poshtëm majtas, me sfumaturë.

24. Kuti paketimi suvenir

Kuti version elegant druri, përmasat gjatësia 28 cm, gjerësia 25 cm, lartësia 10 cm, hapje nga sipër (kapak i mbyllshëm sipër ose me magnet), cepat lehtësisht të rrumbullakosur për siguri dhe elegancë, materiali dru natyral, sipërfaqja e lëmuar, me teksturë druri të dukshme dhe të trajtuar me vaj natyral ose llak mat,

ngjyra dru natyral (kafe e ngrohtë e artë). Dizajni i brandimit Logo & Tekst & Slogani:(Briri me krahë & Posta Shqiptare & “SHPEJT • SIGURT • KUDO”. Pozicionimi: Pjesa e sipërme e kutisë, poshtë-djathtas, ngjyrë e verdhë (gold-yellow), e stampuar ose e gdhendur me laser.

25. Kuti tavoline për mbajtjen e kartopecetave

Forma kubike klasike, përmasat gjatësi 12 cm, gjerësi 12 cm, lartësi 12.5–13 cm. Hapje qendrore sipër për nxjerrje të kartopecetave me buzë të lëmuara. Materiali plastikë e ngurtë me veshje mate, ngjyra blue errët (sipas ngjyrave të përcaktuara në brandbook-un e Postës Shqiptare) Logo & Tekst & Slogani:(briri me krahë & Posta Shqiptare & “SHPEJT • SIGURT • KUDO”. Pozicionimi vendosur në qendër të faqes përballë. Logoja dhe teksti ngjyrë e verdhë e ndezur ose gold matte.

26. Sticker për dhurata

Sticker për Dhurata – Posta Shqiptare (versioni gold elegant). Forma rrethore, ngjyra bazë ari metalik (gold foil) në sipërfaqe matte ose me shkëlqim të lehtë. Logo: Simboli klasik me krah (briri) në ngjyrë kafe të errët ose bronz për kontrast. Teksti “POSTA SHQIPTARE” dhe slogani “SHPEJT • SIGURT • KUDO” me të njëjtën ngjyrë elegante. Diametri standard 7 cm (sipas madhësisë së paketimit).

Material:Vinil i hollë ose etiketa PVC me sipërfaqe gold foil.Shtresa ngjytese në pjesën e pasme me mbulesë letre për lehtësi në përdorim.

27. Aksesor për tavolinë me pendë dhe bojë

Një set elegant i pozicionuar mbi një bazament dekorativ, përbërë nga pendë klasike me majë metalike, shishe boje e zezë, bazament tavoline me logo të stampuar të Postës Shqiptare. Përmasat: Baza ovale gjatësi 20–25 cm, gjerësi 10–12 cm, lartësi: 2.5 cm. Pendë gjatësi totale 20 cm, material pendë sintetike e fortë në ngjyrë blu e errët. Mbajtësja metalik i artë, shishe boje diametër 5–6 cm, lartësi 6 cm, kapak metal gold me formë sferike për estetikë. Logo & tekst pozicionuar në pjesën ballore të shishes së bojës (Briri me krah & POSTA SHQIPTARE). Baza mund të jetë prej druri të veshur me lëkurë artificiale ose plastike cilësore.

28. Kapele me logo

Kapele ngjyrë blu, material dok, në qendër ka të stampuar me ngjyrë të verdhë logo & tekst (briri me krah & POSTA SHQIPTARE), përbëhet nga kupa (pjesa e sipërme), fiksuesja dhe streha. Kupa duhet të jetë e ndarë në 6 pjesë. Pjesët nga ana e brendshme duhet të jenë të kollaritura.

29. Roll-up promocional

Roll-up me mekanizëm 200x100 cm. PVC. Printuar me 4 ngjyra CMYK U.V., branduar me logon Postës Shqiptare. Tematika, imazhet dhe teksti që do përmbajë baneri i roll-up do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

30. Baner Promocional i personalizuar për aktivitete

Banner promocional i personalizuar për aktivitete me unaza në të katër anët, me përmasa 500x1000 cm i printuar pa bashkime. Printuar me 4 ngjyra CMYK U.V. me logo dhe foto të Postës Shqiptare. Dizajni, tematika, imazhet dhe teksti që do përmbajë baneri promocional do të realizohet nga Kompania fituese në bashkëpunim dhe me miratim të Postës Shqiptare.

31. Dosje lëkure me logo cilësi premium

Dosje zyrtare për mbajtjen e dokumenteve A4 në ambiente institucionale, konferenca ose prezantime zyrtare. Materiali i jashtëm: 100% lëkurë e zezë natyrale. Sipërfaqe e butë, e teksturuar lehtë, kapak i fortë dhe fleksibël, me qepje anësore të zeza shumë të rafinuara mbyllje magnetike e fshehur, logo & tekst (Briri me krah & POSTA SHQIPTARE). Ngjyra e logos: Gold metalik luksoz, me efekt të zbehtë për një pamje elegante. Pozicionimi në pjesën e përparme e stampuar (embossed) ose me shtresë “hot-stamp gold foil”. Përmasat dhe Struktura 24 cm x 32 cm (standarde për dokumente A4). Brendësia xhep anësor për dokumente.

32. Stilolapsa me logo premium + kuti cilësi premium

Stilolaps Premium, materiali resin i lëmuar i zi, aksesorë metalikë gold-plated, kapaku, unazat, klipsi dhe majëza. Logo e stampuar me ngjyrë ar (“POSTA SHQIPTARE” + logo). Pozicionimi i logos: Në pjesën e sipërme të trupit të stilolapsit, nën klipsin e artë. Mekanizmi rrotullues për hapje-mbyllje, me rrëshqitje të butë dhe precize, dimensionet: ~13.8 cm gjatësi, 1.2 cm diametër.

Kutia Prezantuese, forma drejtkëndore me kapak të ngurtë me hapje klasike. Materiali letër e mbuluar me efekt lëkure të zezë. Brendësia mbulesë kadifeje e bardhë, shirit mbajtës saten për fiksimin e stilolapsit. Logo e jashtme e stampuar me ngjyrë ar (“POSTA SHQIPTARE” + logo)

Me qëllim që të kemi një produkt sa më cilësor referuar specifikimeve teknike, kërkojmë nga operatorët tregtarë që gjatë aplikimit të paraqesin edhe mostra të produkteve.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia e matjes	Sasia
1.	Stilolapsa me logo	copë	1500
2.	Bllok i vogël me mekanizëm dhe mbyllje në formë zarfi	copë	200
3.	Note Book me quotes + pulla	copë	100
4.	Dosje të thjeshta me logo publicitare	copë	1000
5.	Çanta të mëdha kartoni	copë	500
6.	Çanta beze	copë	200
7.	Flamuj të mëdhenj + stativë (me logo të Postës)	set	20
8.	Flamuj të vegjël + stativë (Poste + Shqiptar)	set	50
9.	Fletëpalosje (shërbime, histori, inovacion)	copë	100.00
10.	Kalendar tavoline vjetor	copë	100
11.	Postera (tematika të ndryshme)	copë	1000
12.	Varëse çelësash me mekanizëm ku të vendosen pulla	copë	300
13.	Aksesor tavoline për vendosjen e shënimeve	copë	100
14.	Zarfa filatelikë + katalog	copë	100
15.	Vulë me dyllë me gdhendje	copë	5
16.	Printim në adeziv për sinjalistikën e sporteleve	m2	15

17.	Korniza pecikllaz për vendosjen e posterave në formatin 50x70	copë	100
18.	Konkorda (spila) me imazhe të pullave	copë	200
19.	Printim manualit të unifikimit të zyrave postare	copë	50
20.	Suvenir ose mbajtëse për stilolapsa me elementë postar	copë	100
21.	USB 16 giga në format karte bankomati me logo Postës Shqiptare	copë	250
22.	Aromatizues makine	copë	200
23.	Sticker notes me logon e Postës	copë	1000
24.	Kuti paketimi suvenir	copë	100
25.	Kuti tavoline për mbajtjen e kartopecetave	copë	100
26.	Sticker për dhurata	copë	100
27.	Aksesor për tavolinë me pendë dhe bojë	set	100
28.	Kapele me logo	copë	200
29.	Roll-up promocional	copë	20
30.	Baner Promocional i personalizuar për aktivitete	copë	1
31.	Dosje lëkure me logo cilësi premium	copë	50
32.	Stilolapsa me logo premium + kuti cilësi premium	set	100

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për stafin e punonjësve si dhe list pagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Qershor – Gusht 2025, nga të cilët:

-1 punonjës i diplomuar për disegner grafik

Për punonjësit e stafit teknik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: Kontratën individuale të punës/ kontrata bashkëpunimi, dhe diploma/certifikime nga kompani/institucione të certifikuara si edhe të figurojnë në listpagesat e kompanisë.

*(Për Kontratën e Bashkëpunimit sqarojmë se duhet të jenë të vlefshme deri në përfundim të kontratës objekt prokurimi dhe jo domosdoshmërisht t'i kenë pjesë të stafit të Pasqyruar në listpagesa)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën:

- Certifikatën **ISO 9001 - 2015** ose ekuivalente.

(Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë dhe provojë se zotëron në pronësi ose me kontratë qiraje të noterizuar, e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës të paktën:

▪ Dy makineri printimi/shtypi industrial.

Njëra prej makinerive duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi 5 m gjerësi pa ndërprerje.

Kjo pikë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes të faturave tatimore të blerjes sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është blerë, deklaratën doganore.

Në rastin e marrjes me qira, të paraqitet i gjithë dokumentacioni i mësipërm, shoqëruar me kontratën noteriale të qiramarrjes e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës, ku pajisja duhet të provohet se është në bilancin e kompanisë qiradhënëse.

(Per makineritë e printimit OE duhet të paraqesë dhe broshurat me informacion të detajuar nga prodhuesi.)

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë përmes së cilës merr përsipër të kryej dizajnin sipas specifikimeve teknike në shtojcën 6.

2.3.6 Operatori ofertues, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat fizike për artikujt sipas shtojcës se specifikimeve teknike, pa logo të postës dhe të papersonalizuara

(Shënim) Mostrat fizike do të vlerësohen të rregullta me ose pa logo të personalizuar ose të papersonalizuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca **10**, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

